





Prokurori i Shtetit/Džravni Tužilac/State Prosecutor
Zyra për Mbrojtje dhe Ndhinë Viktimave
Kancelarija za Zastupanje i Pomoć Žrtvama
Victims Advocacy and Assistance Office



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova
Kosovo Judicial Council



MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

ZYRA PËR MBROJTJE DHE NDIHMË VIKTIMAVE

DHE

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

1.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta duke u bazuar në kompetencat ligjore si dhe funksionet Institucionale ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli) dhe Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (në tekstin e mëtejme: ZMNV), e që kanë për qëllim kryesor ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efikase për viktimat e krimit.

1.2 Aktivitetet e përbashkëta do të përqendrohen në ofrimin e shërbimeve elektronike, dorëzimin e kërkesave për Urdhra Mbrojtës në mënyrë elektronike, sipas kapaciteteve dhe mundësive Këshilli të sigurojë hapësira të punës në Degët e Gjykatave, për stafin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.

Neni 2

Obligimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Këshilli)

Këshilli do të:

2.1 Mundësojë hapësira të punës (Zyre) për stafin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në Degët e Gjykatave, për aq sa është e mundur;

2.2 Mundësojë pranim - dorëzimin të kërkesave për urdhra mbrojtës në mënyrë elektronike (përmes e-mailit);

2.3 Ofrojë qasjen në informata dhe dokumente relevante me natyrën e punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Obligimet e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV)

ZMNV obligohet që:

3.1 Të caktojë personat përgjegjës për realizimin e kërkesave për urdhra mbrojtës;

3.2 Në rast se zyrtaret e saj vendosen në objektin e Degës së Gjykatës, të njëjtit duhet të veprojnë në pajtim me Kodin e Sjelljes dhe Rregullat e vendosura nga Këshilli.

Neni 4

Mbikëqyrja dhe Koordinimi

- 4.1 Për të siguruar zbatim efektiv dhe me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta do të krijohet një grup punues që do të përbëhet nga përfaqësues të të dyja palëve;
- 4.2 Grupi punues do të takohet rregullisht për të planifikuar, vlerësuar dhe raportuar për progresin e arritur në implementimin e kësaj Marrëveshje dhe qëllimit të përbashkët në interes të palëve të përfshira.

Neni 5

Konfidencialiteti dhe përdorimi i informacionit

Të dyja palët angazhohen që të mbajnë dhe ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni të shkëmbyer në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke përdorur të dhënat dhe informacionet vetëm për qëllime të natyrës së punës.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 6.1 Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve. Ndryshimet apo plotësimet eventuale të kësaj marrëveshje do të miratohen me shkrim të ndërsjellë.
- 6.2 Kjo marrëveshje mund të ndërpritet nga cilado palë nënshkruese me paralajmërim të arsyetuar me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë para datës së ndërprerjes së Marrëveshjes.

Neni 7

Hyrja në fuqi

- 7.1 Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje për secilën palë nënshkruese, dy prej të cilave depozitohen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe dy në Prokurorinë e Shtetit/Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.
- 7.2 Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe mbetet në fuqi deri në momentin kur nuk tërhiqet nga palët nënshkruese me paralajmërim paraprak me shkrim.
- 7.3 Marrëveshja e Bashkëpunimit do të publikohet në faqet zyrtare të palëve.

PALËT NËNSHKRUESE

Burhan MAXHUNI

U. d. Koordinator
Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave



Albert ZOGAJ

Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Prishtinë, 25 / 10 /2024